



Ndalimi dhe paraburgimi nga policia

*Pjesë nga raporti i 2-të i Përgjithshëm,
publikuar në vitin 1992*

36. KPT i kushton rëndësi të veçantë tre të drejtave për personat që ndalohen nga policia: e drejta e personit në fjalë që fakti i ndalimit të tij t'i njoftohet një pale të tretë që zgjedh ai (anëtar i familjes, mik, konsullatë), e drejta për t'iu drejtuar një avokati dhe e drejta për të kërkuar ekzaminim mjekësor nga një mjek që e zgjedh ai (krahas ekzaminimit mjekësor të bërë nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹ Ato janë, sipas mendimit të KPT-së, tre garanci themelore kundër keqtrajtitimit të personave të ndaluar të cilat duhet të zbatohen që nga fillimi i heqjes së lirisë, pavarësisht se si mund të përshkruhet kjo sipas sistemit juridik përkatës (kapje, arrestim, etj).

37. Personat që merren në mbikëqyrje në polici duhet të informohen shprehimisht pa vonesë për të gjitha të drejtat e tyre, duke përfshirë ato të përmendura në paragrafin 36. Më tej, çfarëdo mundësisht që u janë ofruar autoriteteve për të shtyrë ushtrimin e njerës apo tjetrës nga këto të drejta të fundit në mënyrë që të mbrohen interesat e drejtësisë duhet të përcaktohen qartë dhe zbatimi i tyre të kufizohet rigorozisht në kohë. Lidhur më në hollësi me të drejtat për avokat dhe për një vizitë mjekësore nga një mjek i ndryshëm prej atij të thirrur nga policia, sistemet, nëpërmjet të cilave sidomos avokatët dhe mjekët mund të zgjidhen nga lista të paracaktuara të hartuara në marrëveshje me organizatat përkatëse profesionale, duhet të eliminojnë çdo nevojë për të shtyrë ushtrimin e këtyre të drejtave.

38. E drejta për t'iu drejtuar një avokati për personat në mbikëqyrje në polici duhet të përfshijë të drejtën për të kontaktuar dhe për t'u vizituar nga një avokat (në të dy rastet nën kushte që garantojnë konfidencialitetin e diskutimeve të tyre) si edhe, në parim, të drejtën për personin në fjalë që të ketë të pranishëm avokatin gjatë marrjes në pyetje.

Lidhur me ekzaminimin mjekësor të personave në mbikëqyrje në polici, të gjitha këto ekzaminime duhet të bëhen pa u dëgjuar dhe mundësisht pa u parë nga punonjësit e policisë. Më tej, rezultatet e çdo ekzaminimi si edhe pohimet përkatëse të të ndaluarit dhe konkluzionet e mjekut duhet të evidentohen zyrtarisht nga mjeku dhe t'i jepen të ndaluarit dhe avokatit të tij.

39. Duke u kthyer te procesi i marrjes në pyetje, KPT mendon se duhet të ekzistojnë rregulla ose direktiva të qarta mbi mënyrën se si duhet të bëhen marrjet në pyetje nga policia. Ato duhet të trajtojnë ndër të tjera edhe çështjet e mëposhtme: informimi i të ndaluarit për identitetin (emrin dhe/ose numrin) e atyre që janë të pranishëm në intervistim, kohëzgjatja e lejuar e intervistimit, pushimet ndërmjet intervistave dhe ndërprerjet gjatë një interviste; vendet ku mund të zhvillohen

¹ Me vonë kjo e drejtë është riformuluar si më poshtë: e drejta për t'iu drejtuar një mjeku, duke përfshirë të drejtën për t'u vizituar, në se dëshiron i ndaluarit, nga një mjek që e zgjedh vetë (krahas çdo ekzaminimi mjekësor që kryhet nga një mjek i thirrur nga autoritetet e policisë).

marrjet në pyetje; në se të ndaluarit mund t'i kërkohet të qëndrojë në këmbë kur pyetet; intervistimi i personave që janë nën ndikimin e drogës, alkolit, etj. Duhet gjithashtu të kërkohet që të mbahet një evidencim sistematik i kohës kur fillojnë dhe mbarojnë intervistat, të ndonjë kërkese nga një i ndaluar gjatë intervistës dhe i personave të pranishëm gjatë çdo intervistimi.

KPT do të shtonte se regjistrimi elektronik i marrjeve në pyetje nga policia është një garanci tjetër e dobishme kundër keqtrajtimit të të ndaluarve (si edhe ka avantazhe domethënëse për policinë).

40. KPT mendon se garancitë themelore të dhëna personave në mbikëqyrje në polici do të përforcoheshin (dhe puna e punonjësve të policisë do të kishte mjaft gjasa të lehtësohej) në se do të mbahej një evidencë e vetme përmbledhëse për çdo person të ndaluar, ku do të regjistroheshin të gjitha aspektet e mbikëqyrjes së tij dhe veprimet e ndërmarra lidhur me të (kur ju hoq liria dhe arsyet për atë masë; kur ju thanë të drejtat; shenjat e dëmtimeve, sëmundjes mendore, etj.; kur u kontaktuan të afërmit/konsullata dhe avokati dhe kur u vizitua prej tyre; kur ju ofrua ushqim; kur u pyet; kur u transferua ose lirua etj.). Për çështje të ndryshme (p.sh. sendet që kish personi, fakti që ju thanë të drejtat e tij dhe në se i kërkoi ose hoqi dorë prej tyre), duhet të merret firma e të ndaluarit dhe, në se është e nevojshme, të shpjegohet mungesa e firmës. Për më tepër, avokati i të ndaluarit duhet të ketë akses në evidencën e mbikëqyrjes.

41. Më tej, ekzistenca e një mekanizmi të pavarur për të shqyrtuar ankimet lidhur me trajtimin gjatë mbikëqyrjes në polici është një garanci themelore.

42. Mbikëqyrja në polici është në parim me afat relativisht të shkurtër. Si pasojë, kushtet fizike të ndalimit në ndërtesat e policisë nuk mund të priten të jenë aq të mira sa në vendet e tjera të ndalimit ku personat mund të mbahen për afate të gjata. Sidoqoftë, duhet të plotësohen disa kërkesa materiale elementare.

Të gjitha qelitë e policisë duhet të jenë në përmasa të arsyeshme për numrin e personave që futen në to dhe të kenë ndriçim të përshtatshëm (d.m.th. të mjaftueshme për të lexuar me atë dritë, duke përjashtuar periudhat e fjetjes) dhe ajrim; do të preferohej që qelitë të kishin ndriçim natyror. Më tej, qelitë duhet të pajisen me një mjet pushimi (p.sh. karrike ose stol i fiksuar), dhe personat e detyruar të kalojnë natën në mbikëqyrje duhet të pajisen me një dyshek dhe batanije të pastra.

Personave në mbikëqyrje duhet t'u lejohet të kryejnë nevojat e natyrshme kur është e nevojshme në kushte të pastra e të denja dhe t'u ofrohen kushte të përshtatshme për larje. Atyre duhet t'u jepet ushqim në kohë të përshtatshme, duke përfshirë të paktën një ushqim të plotë (d.m.th. diçka më të plotë se një sanduiç) çdo ditë.²

43. Çështja se sa është një përmasë e arsyeshme për një qeli policie (ose çdo tip tjetër vendmbajtjeje për të ndaluar/të burgosur) është një pyetje e vështirë. Duhet të merren parasysh shumë faktorë kur të bëhet një vlerësim i tillë. Sidoqoftë, delegacionet e KPT ndejnë nevojën për një direktivë të gjerë në këtë drejtim. Kriteri i mëposhtëm (i parë më shumë si nivel i dëshirueshëm se sa një standard minimal) po përdoret aktualisht kur vlerësohen qelitë e policisë që janë për një person për më shumë se sa pak orë: rreth 7 metra katror, distancë ndërmjet mureve dy metra ose më shumë, ndërmjet dyshemesë dhe tavanit 2.5 metra.

² KPT gjithashtu këshillon që personave që mbahen në mbikëqyrje policore për 24 orë a më tepër duhet, sa të jetë e mundur, t'u ofrohet ajrim çdo ditë.